



UNIVERSITETI I PRISHTINËS FAKULTETI I EDUKIMIT

Rr. Agim Ramadani, Fakulteti i Edukimit, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: +383 38 229 209 * Email: edukimi@uni-pr.edu * edukimi.uni-pr.edu

Abstrakt i zgjeruar

Titulli i Punimit:

BASHKËPUNIMI MES MËSIMDHËNËSVE DHE PRINDËRVE TË FËMIJËVE ME
NEVOJA TË VEÇANTA

Autori:

Blerta Hasani

Mentori:

Prof. Asst. Dr. Ardita Devolli

Programi:

Fakulteti i Edukimit: Edukim inkluziv

Viti akademik:

30.04.2026

Hyrja

Bashkëpunimi si një proces dinamik, konsiderohet një ndër sfidat e arsimit bashkëkohor që kërkon ndërveprim ndërmjet mësimeve dhe prindërve për një arsimim efektiv dhe gjithëpërfshirës ndaj fëmijëve me nevoja të veçanta. Qëllimi i këtij studimi është të shqyrtojë bashkëpunimin mes mësimeve dhe prindërve të nxënësve me nevoja të veçanta arsimore duke shqyrtuar efektin e këtij bashkëpunimi në arritjet akademike, aftësitë sociale si dhe në pranimin nga bashkëmoshatarët e këtyre nxënësve në klasë.

Pyetjet e hulumtimit:

1. Si ndikon bashkëpunimi mes mësimeve dhe prindërve në përmirësimin e shkathtësive sociale të fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore?
2. Sa ndikim ka ky bashkëpunim në arritjet akademike të këtyre fëmijëve?

3. Në çfarë mase ndihmon ky bashkëpunim në krijimin e klimës përgjithshme në klasë në pranueshmërinë nga bashkëmoshataret e fëmijëve në klasë.

Hipotezat e këtij hulumtimi:

H1: Ekziston një lidhje pozitive mes bashkëpunimit mësimdhënës-prind dhe zhvillimit të shkathtësive sociale të fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore.

H2: Fëmijët me nevoja të veçanta që kanë mbështetje të përbashkët nga prindërit dhe mësimdhënësit arrijnë rezultate akademike më të larta krahasuar me ata që nuk e kanë këtë mbështetje.

H3: Bashkëpunimi efektiv mes prindërve dhe mësimdhënësve ndikon pozitivisht në klimën e klasës dhe rrit nivelin e pranimet së fëmijëve me nevoja të veçanta nga ana e bashkëmoshatarëve.

Metodologjia

Metodologjia e këtij studimi ka qasje sasiore me dizajn përshkrues dhe korrelacional. Dizajni përshkrues u përdor për të treguar gjendjen aktuale të këtij fenomeni pa ndërhyrje apo manipulim të variablave, ndërsa nga përbërja e pyetjeve hulumtuese tregohet korrelacioni mes variablave të pavarura, respektivisht nivelit të bashkëpunimit të mësimdhënësve dhe prindërve të nxënësve me nevoja të veçanta dhe variablave të varura respektivisht arritjeve akademike, shkathtësive sociale të nxënësve me nevoja të veçanta dhe pranimet nga bashkëmoshatarët e tyre në klasë. Instrumenti i përdorur në këtë hulumtim është pyetësori për mësimdhënës dhe prindër matën bashkëpunimin mes vete si dhe efektivitetin në arritjet akademike, sociale të fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore. Instrumentet e mbledhjes së të dhënave janë përdorur pyetësori për mësimdhënës dhe prindër matën bashkëpunimin mes vete si dhe efektivitetin në arritjet akademike, sociale të fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore. Instrumentet mbështeten nga studimi i (Akhter, 2016) dhe nga shqyrtimi i literaturës. Mostrën e këtij studimi e përfshijnë 80 mësimdhënës të cilët punojnë me nxënës me nevoja të veçanta arsimore dhe 40 prindër të nxënësve me nevoja të veçanta arsimore në shkolla fillore në komunën e Mitrovicës.

Rezultatet kryesore

Rezultatet kryesore të këtij hulumtimi dëshmojnë lidhje pozitive dhe statistikisht të rëndësishme mes bashkëpunimit mësimdhënës-prindër ndaj zhvillimit të shkathtësive sociale të nxënësve me nevoja të veçanta arsimore me vlerat e korrelacionit Pearson $r = 0.227$ dhe $p = 0.43$.

Korrelacion pozitiv u identifikua ndërmjet mbështetjes nga prindërit dhe mësimdhënësit me arritjet akademike të nxënësve me nevoja të veçanta arsimore me vlerat e koeficientit të Pearson $r = 0.350$ dhe $p = 0.001$ që tregon se kjo lidhje është në nivel pozitiv mesatar. U dëshmuua korrelacion shumë të fortë pozitiv mes bashkëpunimit mësimdhënës-prind dhe klimës në klasë me vlerat ($r = 0.689$; $p = 0.000$), ndërsa lidhja me pranimin nga bashkëmoshatarët e tyre është pozitive, por më e moderuar ($r = 0.263$; $p = 0.018$). Rezultatet deskriptive të këtij studimi pasqyrojnë qëndrimet e mësimdhënësve në nivel të lartë, të cilët konsiderojnë bashkëpunimin me prindërit si një faktor kyç në përmirësimin e rezultateve akademike, motivimit dhe integritetit social të nxënësve me nevoja të veçanta arsimore, me vlerat e mesatares dhe devijimit standard të cilat fillonin nga ($M = 3.96$; $SD = .191$) dhe ($M = 4.74$; $SD = .522$).

Diskutimi

Gjetjet e këtij hulumtimi janë në përputhje me literaturën ndërkombëtare (Kaffemanienë, Tomënienë, & Verpečinskienë, 2021; Mann & Gilmore, 2021; Zafarovna, 2025) duke veçuar rëndësinë e bashkëpunimit mes mësimdhënësve dhe prindërve për të arritur zhvillimin e shkathtësive sociale, arritjeve akademike të fëmijëve me nevoja të veçanta si dhe në pranimin nga bashkëmoshatarët e tyre në klasë. Krahasimi me studime të mëparshme tregojnë se edhe në kontekstin e studimit bashkëpunimi ndërmjet shkollës dhe familjes është më i theksuar në aspektet praktike dhe të përditshme të procesit mësimor, ndërsa përfshirja në vendimmarrje më të thelluara pedagogjike mbetet relativisht më e kufizuar.

Përfundimet dhe rekomandimet

Nga ky studim mund të arrijmë në përfundim se bashkëpunimi mes mësimdhënësve dhe prindërve ndikon në arritjet akademike dhe sociale të nxënësve me nevoja të veçanta, si dhe në pranueshmërinë nga bashkëmoshatarët e tyre në klasë. Në kontekst të përgjithshëm studimi mbështet nevojën për investimin e institucioneve arsimore në ofrimin e programeve ndaj praktikave bashkëpunuese në ndërtimin e partneriteteve bashkëpunuese mes familjes dhe shkollës që do të ndikonin në përvetësimin e arritjeve akademike dhe zhvillimin e shkathtësive sociale të nxënësve me nevoja të veçanta arsimore, si dhe në pranimin nga bashkëmoshatarët e tyre në klasë.

Fjalë kyçe: Bashkëpunimi, mësimdhënës, nxënës, prindër.